



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK

DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 10 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-052, për Marrëveshjet Ndërkombëtare si dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit Nr. 03/L-004 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik:

D e k r e t o j

Ratifikimin e Marrëveshjes për Rregullimin reciprok të transportit rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, e nënshkruar në Prishtinë më 24 korrik 2014 dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 04 shtator 2014.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-018-2014.

Prishtinë, më 11 shtator 2014.



Atifete Jahjaga

Presidente e Republikës së Kosovës

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE PËR RREGULLIMIN RECIPROK TË TRANSPORTIT RRUGOR NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE

QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QEVERIA E REPUBLIKËS ITALIANE, në vijim të emëruara si "Palët Kontraktuese", duke pasur parasysh se është në proces finalizimi i marrëveshjes për stabilizim asocim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian me qëllim të lehtësimit dhe rregullimit në interes reciprok të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave ndërmjet dy vendeve, si në destinacion po ashtu edhe tranzit në territoret respektive, kanë rënë dakord si vijim:

Neni 1

Transportuesit e secilës Palë Kontraktuese kanë të drejtë të kryejnë transportin e udhëtarëve dhe të mallrave si në destinacion po ashtu edhe në tranzit në territorin e palës tjetër kontraktues me automjete të transportit të udhëtarëve dhe mallra, të regjistruara në territorin e njërës palë kontraktuese në të cilën ka selinë transportuesi, sipas modaliteteve të përcaktuara me këtë Marrëveshje.

I – TRANSPORTI I UDHËTARËVE

1.1. FUSHA E ZBATIMIT

Neni 2

Në pajtim me legjislacionin në fuqi për hyrjen dhe qëndrimin e personave në territoret e dyja palëve kontraktuese, kjo Marrëveshje zbatohet për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve të kryer ndërmjet territoreve të palëve kontraktuese edhe në transit me automjete të destinuar për transportin e udhëtarëve të pajisura me më shumë se nëntë ulëse, duke përfshirë edhe atë të drejtuesit të automjetit (autobus).

1.2. SHËRBIMET E RREGULLTA NDËRMJET DY VENDEVE

Neni 3

1. Sipas kësaj Marrëveshje shërbimet e rregullta konsiderohet, transporti i udhëtarëve me autobus në itinerarin e përcaktuar sipas orareve dhe çmimeve të përcaktuara dhe publikuara më parë.
2. Transportit të rregullt të udhëtarëve i lejohet zbritja dhe hyrja e udhëtarëve në stacionet e nisjes apo përgjat rrugës.
3. Në qëllim të shërbimit transportuesi obligohet të parnoq në automjet çdo udhëtarë i cili paraqitet në stacionet e nisjes dhe të ndaljes me kusht që të ketë ulëse të lira, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje dhe të ligjeve kombëtare që rregullojnë shërbimet e rregullta linjore për transport të udhëtarëve.

Neni 4

Shërbimet e rregullta ndërmjet dy Vendeve janë ngritur me marrëveshje të përbashkët nga Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese të parapara në nenin 25 të kësaj Marrëveshje dhe mbi bazën e përcaktimeve të Komisionit të Përbashkët të paraparë me neni 26, (në vijim emëruar si Komisioni i Përbashkët).

Neni 5

1. Shërbimi i rregullt i transportit të udhëtarëve kryhet në bazë të një autorizimi, i cili nuk mund të transferohet.
2. Autorizimi sipas paragrafit 1 të këtij neni lëshohet nga Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese për pjesën e rrugës që zhvillohet në territoret respektive kombëtare mbi bazën e reciprocitetit, nëse nuk dakordohen ndryshe autoritetet.
3. Kohëzgjatja e autorizimit përcaktohet me marrëveshje të përbashkët nga Komisioni i Përbashkët.
4. Autorizimi jepet për kryerjen e shërbimeve të rregullta në bazë të kërkesës së paraqitur nga ana e operatorit të transportit tek Autoritetit kompetent të Palës kontraktuese në territorin e së cilit ka selinë ai operator.
5. Kërkesa duhet të përmbajë itinerarin, orarin për tërë vitin, çmimoren dhe treguesit e tjerë të nevojshëm, eventualisht të kërkuar nga Autoritetet kompetente të Palëve kontraktuese. Kërkesa duhet të shoqërohet me një rend të udhëtimit të rrugës së propozuar duke treguar edhe stacionet e ndaljes dhe kilometrazhin.
6. Autoriteti kompetent i njëjës nga Palët kontraktuese i përcjell Palës tjetër kontraktuese kërkesën e pranuar të pajisura me të gjithë dokumentacionin e kërkuar.
7. Kërkesat duhet të aprovohen nga Autoritetet kompetente të Palëve kontraktuese mbi bazën e modaliteteve të përcaktuara nga Komisioni i Përbashkët.
8. Gjatë transportit, në bordin e automjetit të përdorur për shërbimin e rregullt duhet të gjendet origjinali i autorizimit ose kopja e vërtetuar nga origjinali e lëshuar nga i njëjti Autoritet që ka lëshuar origjinalin.

Neni 6

Operatorët transportues nuk mund të kryejnë shërbim të brendshëm të transportit të udhëtarëve në territorin e Palës tjetër kontraktuese.

1.3. SHËRBIME E RREGULLTA TRANZITI

Neni 7

1. Sipas kësaj Marrëveshje, konsiderohet shërbim i rregullt i transportit transit të udhëtarëve me nisje nga territori i Shtetit të njëjës prej Palëve kontraktuese që kalon nëpër territorin e Shtetit të Palës tjetër kontraktuese me destinacion një Vend të tratë, pa marrë apo zbritur asnjë udhëtarë në territorin e Shtetit të Palës tjetër.

2. Shërbimet e rregullta transit kryhen mbi bazën e një autorizimi të lëshuar nga Autoriteti kompetent i Vëndit tranzit, të cilëve transportuesi i ka paraqitur kërkesën nëpërmjet Autoritetit të vëndit të origjinës.

1.4. SHËRBIMET E RASTIT

Neni 8

Sipas kësaj Marrëveshje, shërbimet e rastit konsiderohen:

- a. Transporti me të njëjtin automjet, me të njëjtit udhëtar, përgjat gjithë itinerarit, i cili duhet të fillojë dhe të përfundojë në territorin e vëndit ku automjeti është i regjistruar (udhëtim me dyer të mbyllura);
- b. Udhëtimi i plotë kur hyn në territorin e Palës tjetër kontraktuese dhe kthim bosh në vëndin e regjstrimit të automjetit (udhëtim me kthim bosh);
- c. Udhëtimi bosh në territorin e Palës tjetër kontraktuese për të transportuar në Vëndin e regjstrimit të automjetit grupe të formuara në bazë të një marrëveshje paraprake ndërmjet operatorit transportues dhe një porositësi të shërbimit (udhëtim bosh në vajtje).

Neni 9

1. Shërbimet e potencuara sipas pikës a) dhe b) të nenit 8, të kësaj Marrëveshje, qoftë bilateral apo trazit, kryhen pa asnjë leje (autorizim).
2. Në rastet sipas paragrafit 1 të këtij neni, shoferi i autobusit duhet të ketë me vete në automjet fletë udhëtimin. Modeli i fletë udhëtimit përcaktohet me marrëveshje të përbashkët nga Komisioni i Përbashkët.
3. Në rastin e potencuar sipas paragrafit c) të nenit 8, të kësaj Marrëveshje, Autoriteti kompetent i vëndit në të cilën ka selinë operatori transportues që duhet të kryejë shërbimin duhet t'i kërkojë autorizimin Palës tjetër kontraktuese. Autoritetet kompetentet mund të shkëmbejnë kontingjent të lejeve vjetore të moduleve të autorizimit të përcaktuara nga Komisioni i Përbashkët i kësaj Marrëveshje. Autorizimit duhet t'i bashkëngjitet lista e udhëtarve të transportuar.
4. Autobusi i cili kryen shërbimet e rregullat qoftë edhe ato të rastit, në rastë të defektit, mund të zëvendësohet nga një autobus tjetër pa autorizim në përputhje me rregullat e vendosura nga Komisioni i Përbashkët.

1.5. SHËRBIME TË TJERA ME AUTOBUS

Neni 10

1. Për të gjitha shërbimet e tjera me autobus, që nuk parashihen në nenin 8, të kësaj Marrëveshje është e nevojshme të merret paraprakisht autorizimi i lëshuar nga Autoriteti kompetent i Palës tjetër kontraktuese.

2. Autorizimi sipas paragrafit 1 të këtij neni i lëshohet transportuesit në bazë të kërkesës drejtuar Autoritetit kompetent të Palës kontraktuese në territorin e të cilit ka selinë transportuesi.
3. Kërkesa duhet të përmbajë të dhënat e destinacionit të udhëtimit, të itinerarit, qëllimin e udhëtimit dhe automjetin që do të përdoret dhe gjitha informacionet tjera që kërkohen sipas marrëveshjes së përbashkët nga Autoritetet kompetente të Palëve kontraktuese.
4. Autoriteti kompetent sipas paragrafit 2 të këtij neni i përcjellin kërkesat e pranuar tek Autoritetit kompetent i Palës tjetër kontraktuese duke e shoqëruar me tërë dokumentacionin e nevojshëm.
5. Autoriteti kompetent i Palës tjetër informon mbi vendimin e marrë brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

II – TRANSPORTI I MALLRAVE

Neni 11

1. Operatori transportues me seli në territorin e Shtetit të njëjës prej Palëve kontraktuese që kryen transportin e mallrave duhet të jetë i pajisur me autorizim për transport ndërmjet dy vendeve, të lëshuar nga Autoriteti kompetent i vendit tjetër, me përjashtim të rasteve që parashihen në nenin 12 kësaj marrëveshjeje, dhe në raste kur Komisioni i Përbashkët merr vendim që transporti ndërmjet vendeve të Palëve Kontraktuese kryhet pa autorizim bilateral. Autorizimi është e vlefshme për një udhëtim vajtje – ardhje.
2. Gjatë kryerjes së transportit të mallrave në territorin e vendit të Palës kontraktuese, hyrja, lëvizja dhe qëndrimi i automjeteve si dhe i shoferëve mund t'i nënshtrohen kontrollit dhe masave mbrojtëse kur e kërkojnë nevojat e sigurisë së shtetit, bazuar në reciprocitet dhe proceduarve të veçanta
3. Sipas kësaj Marrëveshjeje, transporti transit konsiderohet transporti nëpër territorin e njëjës palë kontraktuese me destinacion drejt një Shteti të tretë, pa ngarkuar apo shkarkuar mallra në territorin e vendit kontraktues nëpër cilin kaion tranzit.

Neni 12

1. Për transportin e mallrave të renditura më poshtë referuar nenit paraprak, nuk nevojitet autorizim, nëse ligjet që rregullojnë hyrjen, daljen dhe tranzitin e mallrave në territoret e dy Palëve Kontraktuese, nuk nevojitet autorizim specifik nga Autoritetet kompetente si:
 1. transporti i funeraleve;
 2. transporti i materialeve të destinuara për ekspozita/panaire;
 3. transporti i rastit, për mallrat me destinacion aeroportin në rastet e devijimit të shërbimit;
 4. transporti i bagazheve me anë të rimorkiove të bashkangjitura tek automjetet e përdorura për transportin e udhëtarëve dhe transporti i bagazheve me anë të çdo lloj automjeti drejt aeroportit apo nga aeroporti;

5. transporti postar;
 6. transporti i artikujve të nevojshëm për kujdes mjekësor në rastet e ndihmës së shpejtë, para së gjithash në rastet e fatkeqësive natyrore;
 7. transporti i mallrave me vlerë (për shembull, metaleve të çmuara) i kryer me automjete të posaçme të shoqëruara nga policia apo nga forca të tjera mbrojtëse;
 8. transporti i pjesëve të këmbimit për lundrimin detar dhe ajror;
 9. zhvendosja bosh e një automjeti të përdorur për transportin e mallrave dhe i destinuar për të zëvendësuar një automjet të papërdorshëm në territorin e Shtetit tjetër kontraktues, gjithashtu kthimi bosh i automjetit me defekt pas riparimit. Vazhdimi i transportit me automjetin zëvendësues do të kryhet duke shfrytëzuar lejen e lëshuar për automjetin e papërdorshëm;
 10. transporti i bletëve dhe larvave të peshkut;
 11. transporti për qëllim jo komercial i pajisjeve apo kafshëve për shfaqje teatri, muzikore, kinematografike, sportive, të cirkut, të panaireve dhe ato me qëllim regjistrimi në radio apo prodhimi kinematografik apo televiziv;
2. Lista e transporteve të përjashtuara nga autorizimi, sipas këtij neni, mund të pësojë ndryshime nga Komisioni i Përbashkët.

Neni 13

1. Autorizimi nuk mund të transferohet dhe i jep të drejtën operatorit transportues të kryejë transport me një automjet apo disa automjete (kamion pa rimorkio, kamion me rimorkio, triler, rimorkio dhe gjysërimorkio) brenda periudhës së vlefshmërisë së përcaktuar në këtë autorizim, gjithësesi jo më shumë se një vit.
2. Transporti tranzit në territorin e Palës tjetër kontraktuese, nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe janë subjekt i regjimit të autorizimeve.
3. Në rastin e kombinimit mjeteve mund të përdoret një rimorkio ose një gjysmërimorkio e regjistruar në territorin e Palës tjetër kontraktuese.

Neni 14

1. Nuk lejohet ngarkimi i mallrave në territorin e Palës tjetër kontraktuese për t'u shkarkuar në territorin e të njëjtës Palë. (Kabotazh)
2. Gjithashtu është e ndaluar që operatorët transportues me seli në territorin e njëres prej Palëve kontraktuese të kryejnë transport ndërmjet Vendit kontraktues dhe një Vendi të tretë dhe anasjelltas, duke përjashtuar rastet e marrëveshjeve ndërmjet Palëve kontraktuese; në këtë rast, Komisioni i Përbashkët, përcakton një kontigjent autorizimesh, me përjashtim të autorizimeve të posaçme të Vendi të tretë, nëse është e nevojshme.

III - DISPOZITA TË KARAKTERIT TË PËRGJITHSHËM

Neni 15

1. Kushtet për kapacitetet teknike dhe profesionale të Operatorve të transportit, përshtatshmëria e Automjetit, përmbajtja e dokumenteve të nevojshme për automjet, shoferi i aftë për ngasjen e automjetit, mbulimi i sigurimit të përgjegjësishë ndajë Palëve të treta dhe udhëtarëve që transportohen, përcaktohet në përputhje me dispozitat ligjore kombëtare nga organet kompetente të vendit të regjistrimit të automjetit.
2. Kushtet e policës së sigurimit duhet të jenë në përputhje me dispozitat e ligjeve në fuqi në Vendin ku kryhet transporti.

Neni 16

Modalitetet për lëshimin e biletave, për përpilimin e dokumentacionit të kërkuar për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, për mbajtjen e regjistrave dhe për nxjerrjen e të dhënave statistikore për t'u shkëmbyer midis Autoriteteve kompetente, janë të vendosura me marrëveshje të përbashkët nga organet e Palëve kontraktuese.

Neni 17

1. Operatori transportues dhe personeli i punësuar në automjetet në të cilat kryhet transporti në bazë të kësaj Marrëveshje duhet të respektojë rregullat në fuqi lidhur me trafikun dhe transportin rrugor që janë në fuqi në territorin e Palës kontraktuese, kur këto automjete gjenden në territorin e kësaj të fundit.
2. Për shkelje të rregullave të përmendura në paragrafin e mësipërm përgjigjet para Autoriteteve të Palës kontraktuese në territorin e së cilës janë kryer shkeljet.

Neni 18

1. Operatorët transportues të të dyja Palëve Kontraktuese janë të detyruar të respektojë këmbimin valutë, rregullat fiskale dhe doganore në fuqi në territorin e Palës kontraktuese ku kryhet transporti.
2. Komisioni i Përbashkët mund të propozojë lehtësira të karakterit fiskal, që mund të lejohen nga legjislacioni i të dy Shteteve.

Neni 19

1. Secila Palë kontraktuese lejon hyrjen e automjeteve të regjistruara në territorin e Palës tjetër kontraktuese në territorin e saj pa detyrime doganore, pa ndalime dhe kufizime, me kusht që ato të riekportohen.
2. Palët kontraktuese mund të kërkojnë që këto automjete t'i nënshtrohen formaliteteve të nevojshme doganore për importimin e përkohshëm/pranimin e përkohshëm në territoret përkatëse kombëtare.

Neni 20

1. Shoferi i automjetit dhe antarët e tjerë të ekuipazhit të automjetit mund të importojnë/pranojnë përkohësisht, pa detyrime doganore dhe pa taksa hyrëse, një sasi të mjaftueshme të sendeve të nevojshme për nevojat e tyre personale, për nevojat normale të udhëtimit, në një masë proporcionale me kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre në territorin e Palës tjetër kontraktuese, me kusht që të mos shiten.
2. Përfshihen gjithashtu nga detyrimet doganore dhe nga taksat hyrëse, produktet ushqimore për udhëtim dhe një sasi e vogël e duhani, puro dhe cigare të destinuara për përdorim personal, në përputhje me dispozitat doganore në fuqi në territorin e Palës tjetër kontraktuese.

Neni 21

Përfshihen nga detyrimet doganore dhe taksat hyrëse, pa ndalime apo kufizime, lëndët djegëse dhe karburantet që gjenden në rezervuarët normal të automjeteve, duke konsideruar që rezervuari normal është ai i parashikuara nga prodhuesi për llojin e automjetit në fjalë dhe që është i lidhur teknikisht me sistemin e furnizimit të motorit.

Neni 22

1. Pjesët e këmbimit të destinuara për riparimin e automjeti tashmë të importuar/pranuar përkohësisht, që kryen një prej transporteve të parashikuara nga kjo Marrëveshje, përfshihen nga detyrimet doganore dhe nga taksat e hyrëse, pa ndalim apo kufizime, në përputhje me formalitetet doganore të parashikuara nga legjislacioni i Palëve Kontraktuese.
2. Për pjesët e zëvendësuara dhe jo të riekportuara duhet të paguhet detyrimet doganore dhe taksat hyrëse, përveç nëse, në përputhje me dispozitat e legjislacionit të Vëndit të importimit/pranimit këto pjesë janë dhënë falas nga ky Vënd ose janë shkatërruar me shpenzimet nga Palët e interesuara, nën mbikëqyrjen doganore.

Neni 23

1. Faturimi dhe pagesat për shërbimet e transportit të kryera në zbatim të kësaj Marrëveshje, do të duhet të kryhen në valutë lehtësisht të këmbueshme sipas normës së këmbimit të tregut në fuqi në ditën e pagesave.
2. Transferimi duhet të bëhet pa kufizime apo vonesa, pas përmbushjes së detyrimeve tatimore dhe në përputhje me dispozitat për përdorimin e mjeteve të pagesës.
3. Nëse duhet arritur një marrëveshje pagese ndërmjet Palëve kontraktuese, pagesat e përmendura më lartë do të kryhen në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje në pajtueshmëri me dispozitat e përmendura në paragrafin e mësipërm.

Neni 24

Pa rënë ndesh me sanksionet e vendosura në Vëndin ku ka ndodhur shkelja, në rast shkeljeje të dispozitave të kësaj Marrëveshje të kryera në territorin e Palës tjetër kontraktuese,

Autoritati kompetent i Palës kontraktuese në territorin e të cilës është regjistruar automjeti vendos – në bazë të rekomandimit të organit kompetent të Palës tjetër kontraktuese – aplikohen sanksionet si në vijim:

- 1) paralajmërim;
- 2) paralajmërim vërejtje me shkrim që në rast përsëritje do të aplikohen masat e parashikuara nga pikat e mëposhtme 3) ose 4);
- 3) pezullim i përkohshëm i lejes (autorizimit) për të kryer transportin e mallrave apo të udhëtarëve në Vendin ku ka ndodhur shkelja, me kohëzgjatje nga 3 deri më 12 muaj;
- 4) revokim i lejes (autorizimit) për të kryer transportin e mallrave apo të udhëtarëve në Vendin ku ka ndodhur shkelja.

Neni 25

1. Mosmarrëveshjet në zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje do të zgjidhen me anë të konsultimeve dhe negociimeve dypalëshe ndërmjet Autoriteteve kompetente të Palëve kontraktuese (ndërsa nëse nuk arrihet marrëveshja, përmes konsultimeve dhe negociatave çështjet zgjidhen përmes kanaleve diplomatike).

2. Autoritetet kompetente të Palëve kontraktuese përgjegjëse për realizimin e kësaj Marrëveshje janë:

- Për Qeverinë e Republikës së Kosovës: Ministria e Infrastrukturës (Ministria përgjegjëse për Transport) – Departamenti përgjegjës për Transport.
- Për Republikën Italiane: Ministria e Infrastrukturës dhe Transporteve – Departamenti për transportet, lundrimin dhe çështje të përgjithshme dhe personale – Drejtoria e Përgjithshme e transportit rrugor dhe intermodal.

Neni 26

1. Për zbatimin dhe aplikimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje, gjithashtu për zgjidhjen e problemeve të krijuara krijohet një Komision i Përbashkët i përbërë nga përfaqësuesit e Autoriteteve kompetente, me këto kompetenca kryesore:
 1. të shprehë opinione për shërbimet e rregullta të transportit të udhëtarëve, në përputhje me rregullat e kryerjes së këtyre shërbimeve të konsideruara të dobishme për të dyja Palët Kontraktuese;
 2. të përcaktojë me marrëveshje të përbashkët kontigjentin e lejeve për transportin e udhëtarëve dhe të mallrave të parashikuara nga nenet 9, 11, 13, 14 dhe, nëse është rasti, për shërbimet sipas nenit 10 ose përjashtimin nga autorizimi në transportin dypalësh dhe tranzit;
 3. të parapërgaditë modelet e autorizimeve të parashikuara nga nenit 5, 9, 10, 11, 13 dhe 14 e të përcaktojë modalitetet e dhënies/shkëmbimit;
 4. të zgjidhë problemet dhe çështjet që mund të dalin gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje;
 5. të marrë masa që konsiderohen të përshtatshme për të lehtësuar dhe favorizuar zhvillimin e transportit rrugor ndërmjet dy vendeve;
 6. të shqyrtojë mundësinë për të dakorduar me Autoritetet kompetente në lidhje me dhënien e lehtësirave të karakterit fiskal, bazuar në parimin e reciprocitetit dhe që jenë të lejuara sipas dispozitave ligjore në fuqi në të dyja Vendet.

2. Autoritetet kompetente të Palëve kontraktuese do të caktojnë përfaqësuesit të cilët do të takohen në Komisionin e Përbashkët, në mënyrë alternative në territorin e të dy Vendeve, me kërkesë të njëres prej Palëve kontraktuese.

Neni 27

1. Legjislacioni i brendshëm i secilës Palë kontraktuese do të zbatohet për të gjitha çështjet që nuk janë rregulluar nga kjo Marrëveshje apo nga Konventat Ndërkombëtare në të cilat janë antare të dyja Palët Kontraktuese.
2. Kjo Marrëveshje nuk cënon detyrimet e Palëve Kontraktuese që rrjedhin nga Marrëveshjet dypalëshe apo shumëpalëshe, dhe për sa i përket Republikës Italiane, detyrimet që rrjedhin nga qenia e saj si pjesë e Bashkimit European.

Neni 28

1. Drejtuesit e automjeteve dhe personeli i punësuar në automjetet për transport të udhëtarëve dhe mallrave në kuptim të kësaj Marrëveshje janë të detyruar të respektojnë dispozitat ligjore, rregulluese dhe administrative në fuqi në Shtetin kontraktues në të cilin zhvillohet transporti dhe në veçanti legjislacionin kombëtar që rregullon hyrjen dhe qëndrimin në territoret përkatëse.
2. Palët kontraktuese rezervojnë të drejtën për të pezulluar lirinë e lëvizjes reciproke kanë në përgjithësi të drejtën për të hequr lirinë e lëvizjes reciproke në rastë kur kërkohet për shkak të sigurisë së shtetit.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 29

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit pasues nga data e konfirmimit të marrjes së njoftimit të dytë nga dy njoftimet me të cilat Palët kontraktuese njoftojnë njëra tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme për ratifikim.
2. Kohëzgjatja e kësaj Marrëveshje do të jetë një vit dhe do të jetë e rinovueshme në mënyrë të heshtur për periudha të mëpasme prej një viti, me përjashtim të rasteve të revokimit, që duhet njoftuar tre muaj para përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

Në dëshmi të kësaj, Përfaqësuesit e nënshkruar, të autorizuar nga Qeveritë përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në Prishtinë më 24/07/2014 në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe në dy kopje origjinale në gjuhën italiane, të dy tekstet janë autentike.

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës

Për Qeverinë e Republikës Italiane

